



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0296**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi Kryetar, Agon Ramadani - anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “El-Bau sh.p.k.” me seli në Gjilan, kundër njoftimit për kontratë, dokumenteve të dosjes së tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi-Gjilan”, me numër të prokurimit 651-23-3604-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal- Gjilan, me datën 05.07.2023, mori këtë:

### Vendim

1. Aprovohet, pjesërisht si e bazuar ankesa e “El-Bau sh.p.k.” me nr. 2023/0296, e datës 22/05/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan”, me numër të prokurimit 651-23-3604-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal- Gjilan.
2. **Anulohet**, njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Shërbime të bartjes me merimangë dhe bllokimi i veturave”, me numër të prokurimit: 600-22-12382-2-1-1, iniciuar nga AK– Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking Sh.A. Obligohet AK që ti bëjë ndryshimet e rekomanduar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë sipas nenit 57 par 3 të LPP-së.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 14.04.2023, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin të prokurimit me titull: “Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan” me nr. të prokurimit: 616-23-4575-2-2-1.

AK-Ka publikuar formularin standard për korigjimin e gabimeve të tenderit me datat 28.04.2023,03.05.2023,05.05.2023,16.05.2023 AK ka publikuar formularin standard për korigjimin e gabimeve të tenderit. Me datë 05.05.2023, OE ankues “El-Bau sh.p.k.” nga Gjilani ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi i Komunës së Gjilanit , me datë 12.05.2023 AK e ka aprovuar pjesërisht kërkesën për shqyrtim. Me datën 22.06.2023 OE ankues “El-Bau sh.p.k.” nga Gjilani, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 296/2023, kundër Njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 2.400.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP. Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 05 Qershor 2023 me raportin e ekspertizës. AK-Kuvendi Komunës së Gjilanit me datë 09.06.2023 ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk është deklaruar në lidhje me raportin e ekspertizës.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 05.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “El-Bau sh.p.k.” nga Gjilani të aprovohet, si pjesërisht bazuar.

- AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit.

*-Seanca dëgjimore-*

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

#### Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

OE ankues pretendon që AK ka vendosur kritere diskriminuese në DT në lidhje me kapacitetin profesional, si dhe pretendon që të njëjtat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Teksti i plotë i pretendimeve ankimore të OE ankues është dhënë në sesionin 2 të këtij raporti, prandaj këtu do t'i referohemi atyre për aq sa është e nevojshme. Në përgjigje të Kërkesës për rishqyrtim të OE ankues, të deponuar më 05.05.2023, AK në vendimin e datës 12.05.2023 kishte vendosur që të cilësoj kërkesën si pjesërisht të bazuar. Ndonëse, AK ka deklaruar që do të bëj korrigjimin e DT dhe të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit, nga përmbajtja e Vendimit nuk ishte e qartë se cilat pretendime janë cilësuar si të bazuara. Konsideroj që arsyetimi i vendimit nuk i përshtatet cilësimit si “pjesërisht e bazuar”. Në bazë të këtij arsyetimi, kërkesa për rishqyrtim do të duhej të refuzohej si e pabazuar. Vendimit po ashtu i mungon këshilla juridike për OE ankues. Fillimisht, duhet theksuar që me DT është lejuar mundësia që OE-të të angazhojnë stafin profesional përmes marrëveshjeve për angazhim enkas për këtë aktivitet prokurimi (në rast se u mungojnë profilet e përcaktuara). Edhe pse ofrimi i një alternative të tillë e adreson në një masë pretendimin kryesor të OE që kriteret për stafin profesional janë kufizuese dhe diskriminuese, sidoqoftë pretendimet e OE ankues do të duhej të trajtoheshin edhe nga prizmi i relevancës dhe proporcionalitetit në raport me lëndën e aktivitetit prokurues.

Pretendimi 1 OE ankues pretendon që kërkesa për “Inxhinier të diplomuar ose master i diplomuar, drejtimi Menaxhimi i Emergjencave” nuk është relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës. Po ashtu, OE ankues pretendon që kualifikimi inxhinier i drejtimit Menaxhim i Emergjencave nuk ekziston sipas sistemit kombëtar të kualifikimeve në Republikën e Kosovës. OE ankues më tutje pretendon që kërkesa për ekspert të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë është në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e Rregullores (MPMS) Nr.01/2021. Në arsyetimin e AK-së për refuzimin e këtij pretendimi, është thënë që për arsye se puna do të zhvillohet në njërin prej arterieve kryesore të qytetit të Gjilanit dhe pasi që puna që do të zhvillohet është mjaft komplekse dhe ka gërmime të mëdha në infrastrukturë, është kërkuar që të angazhohet një inxhinier i diplomuar për Menaxhimin e Emergjencave dhe i njëjti duhet të jetë i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë. Përgjigja e AK-së në pretendimet e OE ankues në këtë pikë nuk është adekuate, pasi që sipas këtij të fundit, kualifikimi inxhinier i drejtimit Menaxhim i Emergjencave nuk ekziston sipas sistemit kombëtar të kualifikimeve në Republikën e Kosovës. Po ashtu, kriteri shtesë që “inxhinieri” të jetë i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë sipas vlerësimit tim mund të konsiderohet si kufizues, pasi që OE-të mund të kenë staf që është i certifikuar për këtë lëmi, por që jo domosdoshmërisht janë të diplomuar në drejtimin e Menaxhimit të Emergjencave. Pra, nëse kërkesa për këtë certifikim konsiderohet nga AK si

legjitime për projektin në fjalë, rekomandohet që një kërkesë e tillë të merret si e përmbushur nga OE-të nëse e kanë të punësuar (apo e angazhojnë me marrëveshje të veçantë) një person që është i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë, pavarësisht kualifikimit profesional. Rrjedhimisht, vlerësoj që pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 2 OE ankues pretendon që kërkesa për “Inxhinier të diplomuar ose master i diplomuar drejtimi Infrastrukturë Rrugore” është kërkesë kufizuese dhe diskriminuese. OE ankues pretendon që sipas të dhënave të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, programi apo drejtimi i studimit Infrastrukturë Rrugore nuk ekziston as në nivelin Bachelor as në atë Master. Në arsyetimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues, në lidhje me këtë pikë, AK ka deklaruar që Infrastruktura Rrugore ekziston si program në Universitetin Publik të Kosovës. Ne përgjigjën e ekspertit shqyrtues AK ka deklaruar se sipas dokumenteve zyrtare të Universitetit të Prishtinës një program i tillë për herë të parë është akredituar në vitin e akademik 2012. Këtë e kanë dëshmuar përmes shpalljes se konkursit për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve post diplomike-Master për vitin akademik 2012-13. Megjithatë, në faqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”: <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,143> nuk figuron një program i tillë studimi. Ndonëse një drejtim i tillë ka ekzistuar në të kaluarën, konsideroj që AK-të do të duhej të përditësonin kërkesat e tyre paralelisht me azhurnimin e programeve të studimit që ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, duke mundësuar alternativa të kualifikimeve profesionale që konsiderohen të barasvlershme. Rrjedhimisht, konsideroj që pretendimi i dytë i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 3 OE ankues pretendon që kërkesa për “Inxhinier të diplomuar ose master i diplomuar i Hidroteknikës [...], i certifikuar për hartimin e elaborateve për mbrojtje nga zjarri” nuk është relevante dhe as proporcionale në lidhje me projektin në fjalë. OE ankues pretendon që një kërkesë e tillë është në kundërshtim me fushën e programit të studimit të Hidroteknikës; nuk përputhet me natyrën e punëve të përshkruara në DT; nuk është një kërkesë e zakonshme në aktivitetet e prokurimit të natyrës së ngjashme të iniciuara më parë nga i njëjti AK; si dhe DT nuk ka paraparë hartimin e elaborateve për mbrojtje nga zjarri. Sikurse tek pretendimi 1, edhe në këtë rast kriteri shtesë që stafi i kërkuar me pikën 2.6 të jetë “i certifikuar për hartimin e elaborateve për mbrojtje nga zjarri” sipas mendimit tim mund të konsiderohet si kufizues, pasi që OE-të mund të kenë staf që është i certifikuar për këtë lëmi, por që jo domosdoshmërisht janë të diplomuar në drejtimin e Hidroteknikës. Pra, nëse kërkesa për certifikimin në fjalë konsiderohet nga AK si relevante për aktivitetin e prokurimit, atëherë rekomandohet që një kërkesë e tillë të merret si e përmbushur nga OE-të nëse e kanë të punësuar (apo e angazhojnë me marrëveshje të veçantë) një person që është i certifikuar për hartimin e elaborateve për mbrojtje nga zjarri, pavarësisht kualifikimit profesional. Po ashtu, AK-të do të duhej të ishin më të vëmendshme me rastin e hartimit të DT, në përshkrimin e punëve dhe detyrave të stafit profesional që kërkohet për aktivitetin e prokurimit, në mënyrë që të mos krijojnë kërkesa/përgjegjësi shtesë me vendimet e tyre, pas shqyrtimit të ankesave të OE-ve. Konsideroj që edhe ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 4 OE ankues pretendon që kërkesa “Inxhinier i diplomuar ose master i Gjeodezisë, i licencuar” nuk është drejtpërdrejtë relevante dhe e nevojshme për objektin e kontratës. Sipas OE ankues, për aktivitetin e prokurimit në fjalë licenca do të duhej të ishte për matje kadastrale dhe jo gjeodezike. AK në arsyetimin e Vendimit të tij ka vlerësuar që një kërkesë e tillë është valide dhe relevante për natyrën e punës, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe vëllimin e punës. Eksperti shqyrtues ka vërejtur që një e njëjta kërkesë është përsëritur në disa aktivitete prokurimi të natyrës së ngjashme dhe si e tillë nuk paraqet një precedent. Ndërsa, licencimi i gjeodetëve është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (MMPH) Nr.13.2019. Rrjedhimisht, konsideroj që ky pretendim është i pabazuar.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të obligohet Autoriteti Kontraktues që t’i bëjë korrigjimet e nevojshme në Dosjen e Tenderit dhe të vazhdoj aktivitetin e prokurimit në pajtim me kërkesat e LPP-së dhe akteve nënligjore përkatëse.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se ka prova të mjaftueshme dhe se administrimi i tyre dhe vendimi meritor lidhur me çështjen në rastin konkret, mund të merret dhe pa dëgjimin e palëve, sikurse parashihet kjo me dispozitën e nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli Shqyrtues, bazuar në shkresat e kësaj lënde, duke i krahasuar dhe analizuar të gjitha ato, veçoi në këtë rast gjetjet dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, përkitazi me hulumtimet e tij për secilin pretendim posaçërisht, siç prezantohen shkurtimisht në vijim këtij të arsyetimi.

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli. Andaj, tek pretendimit nr. 2 sa i përket “Inxhinier të diplomuar ose master i diplomuar drejtimi Infrastrukturë Rrugore”, AK duhet të siguroj ekuivalencën e kësaj kërkesë dhe ta precizoj saktë. ndërsa lidhur me certifikatat e kërkuara, konsiderojmë se të njejtat kanë arsyeshmerinë në aspektin e kërkesës sipas të të gjeturave të ekspertit, por fakti që të njejtat kërkojnë që ti posedojnë inxhinierët specifik konsideroj se mund të shpie në diskriminim dhe ngushtim të konkurrencës, andaj të njejtat të lejohet që të paraqiten nga cilido posedues në listën e punëtorëve, në të kundërtën kriteri i tillë klasifikohet si kriter padrejtësisht i rreptë.

Kështu që, AK nëpërmjet korrigjimit të procedurës përkatësisht Formularit (B54) t’i bëjë përmirësimet e nevojshme dhe të veproj në pajtim me nenin 53.7 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - EL-BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: